

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI Nr. 02/L-128

**PËR BARNAT NARKOTIKE, SUBSTANCAT PSIKOTROPE DHE
PREKURSORE**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të kreut 5.1(ë) dhe 9.1.26 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2001/9 të datës 15 Maj 2001.

Miraton:

**LIGJ PËR BARNAT NARKOTIKE, SUBSTANCAT PSIKOTROPE DHE
PREKURSORE**

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

a) Ligji rregullon prodhimin, qarkullimin me shumicë dhe pakicë, importin, eksportin, kalimin tranzit, transportin, blerjen, furnizimin, shitjen, posedimin, konsumimin, përdorimin dhe propagandimin e bimëve prej të cilave mund të përfitohen narkotikët, barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët.

b) Përcakton obligimet e autoriteteve kompetente të cilat kanë lidhshmëri me këto substanca;

c) Bënë klasifikimin e bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve në bazë të rrezikshmërisë së tyre, gjatë përdorimit në mjekësi dhe veterinari;

d) Përcakton masat e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimit të bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

e) Përcakton masat ndëshkimore në rast të shkeljeve së dispozitave të këtij ligji, dhe akteve normative në bazë të këtij ligji.

Neni 2 Përkufizimet

2.1 përkufizimet si vijojnë, kanë këto riformulime:

Bima nënkupton bimën apo pjesën e bimës nga e cila mund të përfitohet bari narkotik dhe substanca psikotrope (më tutje, bimët), siç janë: bima e kanabisit, opiumit, pjesët e bimës së kokës dhe bimë të tjera që mund të shfrytëzohen për këtë qëllim;

Kultivimi i bimëve për përfitim të barnave narkotike nënkupton furnizimin dhe posedimin e farërave, mbjelljen, rritjen e bimës, marrjen dhe posedimin e pjesëve të bimës të cilat nevojiten për përfitimin e barnave narkotike;

Bar narkotik nënkupton çdo substancë, natyrore ose sintetike, të paraqitur në Tabelën II si shtojcë e këtij ligji të bazuar në Listat I, II dhe IV të Konventës së Vetme për Barnat Narkotike të vitit 1961, të përmisuara me protokolin e vitit 1972;

Substancë psikotrope nënkupton çdo substancë, natyrore ose sintetike, të paraqitur në Tabelën 3 si shtojcë e këtij ligji të bazuar në Listat I, II, III dhe IV të Konventës mbi Substancat Psikotrope të vitit 1971;

Narkotikë nënkupton barnat narkotike dhe substancat psikotrope, që janë të renditura në Tabelat I, II dhe III, të bashkangjitura si shtojcë e këtij ligji (në vazhdim, Tabela I, II dhe III), nëse substancat psikotrope nuk janë posaçërisht të paraqitura;

Prekursor nënkupton çdo substancë, natyrore ose sintetike, që mund të përdoret për përfitimin e barit narkotik ose substancës psikotrope, të paraqitura në Tabelën IV, të bazuar në Listat I dhe II të Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1988 Kundër Trafikimit Ilegal të Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope dhe në Rregulloren (EC) Nr 273/2004 të Këshillit dhe Parlamentit Europian të datës 11.02.2004 mbi prekursorët. Çdo substancë tjetër e paraqitur në Tabelën IV të këtij Ligji konsiderohet si prekursor;

Analog është cilado substancë e palejueshme, struktura kimike e së cilës është dukshëm e ngjashme me atë të bimëve, barnave narkotike dhe substancave psikotrope, efektet e të cilave i riprodhon;

Veprimtari nënkupton operimin me narkotikë/psikotrop, operimin me prekursorë, transportin, posedimin, konsumimin, dhënien falas dhe propagandimin e tyre;

Operim me narkotikë, përgatesat e tyre dhe operim me prekursorë, nënkupton prodhimin, importin, exportin, kalimin tranzit, furnizimin, blerjen, shitjen, deponimin, përdorimin dhe dhënien e tyre me recetë;

Prodhimi nënkupton përgatitjen, përpunimin, ripërpunimin, përzierjen, pastrimin, ambalazhimin, etiketimin dhe çdo proces tjetër që përdoret për përfitimin final të barnave narkotike dhe substancave psikotrope;

Paisjet për përpunimin e barnave narkotike nënkupton pajisjet të cilat përdoren për përfitimin e barnave narkotike ose substancave psikotrope;

Përgatesa nënkupton tretësirën ose përzierjen, në çfarëdo forme fizike që përmban një ose më shumë narkotikë në dozimin terapeutik ose jo-terapeutik të paraqitur në Tabelën III si shtojcë e këtij ligji të bazuar në Listën III të Konventës Unike për Barnat Narkotike të vitit 1961, të plotësuar me protokolin e vitit 1972;

Posedimi nënkupton posedimin faktik të bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

Konsumimi nënkupton marrjen e bimëve dhe të narkotikëve, rregullisht apo kohë pas kohe, me rrugë: orale, inhalatore, parenterale apo rektale;

Sëmundja e varësisë - nënkupton varësinë, fizike dhe psikike që zhvillohet si pasojë e konsumimit të barnave narkotike dhe substancave psikotrope;

Përdoruesi i narkotikëve - nënkupton personin i cili, si rezultat i konsumimit të barnave narkotike ose substancave psikotrope, ka varësi fiziologjike, fizike dhe psikike ndaj tyre;

Mostër reprezentative nënkupton sasinë e bimës, narkotikëve ose prekursorëve nga e cila mund të përfitohen të dhënat komplete lidhur me atë lloj të bimës, narkotikut apo prekursorit qoftë për qëllime mjekësore, të hulumtimeve shkencore, edukative, policore apo për identifikimin e këtyre substancave për qëllime të proceseve gjyqësore, për mjekësi ligjore dhe qëllime të tjera;

Keqpërdorimi i narkotikëve nënkupton kryerjen e veprimtarisë me bimë, barna narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

Operues nënkupton personin fizik ose personin juridik që operon me barna narkotike, substanca psikotrope ose prekursorë në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

Licenca e operimit me narkotikë dhe Licenca e Operimit me Prekursorë nënkupton licencën e aktivitetit ekskluziv për operimin legal me narkotikë dhe prekursorë, të lëshuar për një periudhë të caktuar nga Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet AKPM, për prodhuesit, qarkulluesit farmaceutik me shumicë, qarkulluesit farmaceutik me pakicë dhe institucionet shëndetësore, veterinare, shkencore, edukative dhe policore. Kushtet e licencës do të specifikojnë llojet e vetme të aktivitetit të lejuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale;

Licenca e importit dhe eksportit të narkotikëve dhe licenca e importit dhe eksportit të prekursorëve, nënkupton lejen zyrtare, me shkrim, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet AKPM, që të importohet ose eksportohet dërgesa e narkotikëve dhe prekursorëve në Kosovë.

Neni 3 Kufizimet e veprimtarisë me narkotikë

3.1 Ndalohet çdolloj veprimtarie me bimët dhe narkotikët nga Tabela I e këtij ligji, përveç për qëllime të hulumtimeve shkencore, edukative dhe policore.

3.2 Ndalohet kultivimi i bimëve nga të cilat mund të përfitohen narkotikët.

3.3. Ndalohet çdolloj veprimtarie me bimë, barna narkotike dhe substanca psikotrope të cilat i takojnë Tabelës II, III dhe me prekursorë nga Tabela IV e këtij ligji, përveç për qëllime mjekësore, veterinare, shkencore, edukative, mjeko-ligjore dhe policore

3.4 Ndalohet posedimi i pajisjeve për përpunimin e narkotikëve përveç personave juridik të cilët posedojnë licencë për prodhim të barnave narkotike dhe substancave psikotrope.

3.4 Ndalohet propagandimi direkt apo indirekt i narkotikëve dhe propagandimi i çdo lloji të veprimtarisë me bimë, barna narkotike dhe substanca psikotrope përveç në revistat shkencore dhe profesionale.

Neni 4 Përcaktimi i nevojave vjetore për bimë, barna narkotike, substanca psikotrope

4.1 Përcaktimi i nevojave vjetore të barnave narkotike dhe substancave psikotrope nga Tabela II dhe III e këtij ligji, të cilat mund të prodhohen, importohen, eksportohen dhe të cilat mund të nxirren në treg në territorin e Kosovës, bëhet nga Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale (në vazhdim AKPM).

4.2 AKPM vlerëson dhe përcakton nevojat vjetore nga paragrafi 1 i këtij neni për secilin operues me narkotikë, në bazë të raporteve të personave juridik të licencuar për operim me narkotikë, të cilët dorëzohen jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo tre mujori.

4.3 Përcaktimi i nevojave vjetore të institucionet nga neni 15 dhe 16 për bimëve dhe narkotikëve nga Tabela I, II dhe III e këtij ligji, bëhet nga ana e Komisionit për narkotikë, në bazë të raporteve gjashtëmujore të cilat dorëzohen jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të gjashtëmujorit.

4.4 AKPM, pas miratimit të Ministrit të Shëndetësisë, i dorëzon raportet përfundimtare vjetore dhe vlerësimin e nevojave vjetore për barna narkotike dhe substanca psikotrope Komisionit për narkotikë deri më 31 Mars të vitit vijues.

4.5 AKPM në pajtim me konventat ndërkombëtare për kontrollin e narkotikëve, i dorëzon Autoriteteve ndërkombëtare, veçanarisht Bordit ndërkombëtarë për kontroll të narkotikëve, të dhënat për nevojat vjetore për barna narkotike dhe substanca psikotrope për territorin e Kosovës .

Neni 5 Përcaktimi i nevojave vjetore për prekursorë

5.1 Përcaktimi i nevojave vjetore për prekursorë nga Tabela IV e këtij ligji, të cilët mund të prodhohen, importohen dhe plasohen në treg në territorin e Kosovës, bëhet nga AKPM.

5.2 AKPM vlerëson nevojat vjetore nga paragrafi 1 i këtij neni në bazë të raporteve të personave juridik të licencuar për operim me prekursorë, të cilët dorëzohen jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo tre mujori si dhe nga raportet vjetore të Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë për prekursorët që kanë përdorim në industri.

5.3 AKPM, pas miratimit të Ministrit të Shëndetësisë, i dorëzon raportet përfundimtare vjetore dhe vlerësimin e nevojave vjetore për prekursorë Komisionit për narkotikë deri më 31 Mars të vitit vijues.

5.4 AKPM, në pajtim me konventat ndërkombëtare për kontrollin e narkotikëve, i dorëzon Autoriteteve ndërkombëtare, veçanarisht Bordit Ndërkombëtar për Kontroll të Narkotikëve, të dhënat për nevojat vjetore për prekursorë për territorin e Kosovës .

Neni 6 Themelimi i Komisionit për narkotikë

6.1 Për kordinimin e aktiviteteve të ministrive dhe autoriteteve të tjera kompetente, si dhe të subjekteve të tjera të kyçura në zbatimin e Strategjisë të vendit për kontroll të narkotikëve dhe evitimin e keqpërdorimit të narkotikëve në Kosovë, si dhe me qëllim të promovimit dhe kontrollimit të zbatimit të strategjisë të vendit, Qeveria themelon Komisionin për Narkotikë (në vazhdim: Komisioni).

6.2 Anëtarë të Komisionit për Narkotikë janë ekspertë në lëminë e narkotikëve, të emëruar nga: Ministria e Shëndetësisë (3 anëtarë): AKPM, Klinika e Psikiatrisë e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike; Ministria e Punëve të Brendshme (1), Ministria e Drejtësisë (1), Ministria e Bujqësisë (1), Ministria e Rinisë, Sportit dhe Kulturës (1), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (1), Ministria e Industrisë dhe Tregtisë (1), Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale (1), Ministria e Ekonomisë dhe Financave (1), Ministria e Pushtetit Lokal (1), Sektori i Shërbimit Doganor (1), sektori joqeveritar, duke përfshirë organizatat e shfrytëzuesve të shërbimeve për sëmundje të vartësisë (2), si dhe struktura të tjera përkatëse, që specifikohen nga Qeveria.

6.3 Funkzionet e Komisionit për narkotikë janë:

a) pranimit dhe analiza e raporteve të dorëzuara nga autoritetet kompetente që kanë të bëjnë me narkotikë;

- b) shqyrtimi i aplikacioneve dhe dhënia e pëlqimit për veprimtari me bimë dhe narkotikë nga Tabela I, II dhe III, institucioneve për hulumtime shkencore, mjekësore, edukative dhe mjekësi ligjore;
- c) shqyrtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me narkotikë e prekursorë dhe dhënia e propozimeve për zbatimin e konventave ndërkombëtare përkitazi me kontrollin e narkotikëve;
- d) hartimi i strategjisë për kontrollin e narkotikëve dhe prekursorëve, si dhe parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve të varësisë ; të cilën përmes Qeverisë e dorëzon në Kuvend për miratim;
- e) propagandimi i veprimeve parandaluese dhe informimi publik për pasojat e keqpërdorimit të narkotikëve;
- f) zhvillimi i sistemit për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave përkitazi me natyrën dhe përhapjen e keqpërdorimit të narkotikëve në territorin e Kosovës;
- g) koordinimi dhe përkrahja e aktiviteteve të organizatave joqeveritare dhe organizatave të tjera në parandalimin dhe trajtimin e keqpërdorimit të narkotikëve;
- h) propozimi i ligjeve dhe dispozitave të tjera si dhe mekanizmave të tjerë të veprimit përkitazi me problematikën e keqpërdorimit të narkotikëve;
- i) realizimi i detyrave të tjera të parashtruara nga Qeveria.

6.4 Komisioni propagandon zbatimin efikas të konventave ndërkombëtare mbi kontrollin e narkotikëve, posaçërisht bashkëpunimin ndërkombëtarë mbi kontrollin e narkotikëve dhe veprimin preventiv, marrëdhënjet mes shteteve dhe trupave ndërkombëtar për kontrollin e narkotikëve dhe prekursorëve, si dhe pengimin e keqpërdorimit të tyre.

6.5 Detyrat, përgjegjësitë, mënyra e funksionimit të komisionit, financimi dhe kompenzimi i anëtarëve të Komisionit do të përcaktohen në bazë të aktit nënligjor të hartuar nga Qeveria duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji.

KAPITULLI II

AUTORITETET KOMPETENTE FUNKSIONET DHE RAPORTIMI

Neni 7

7.1 Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet AKPM, është përgjegjëse për detyrat vijuese, sipas dispozitave të këtij ligji dhe Ligjit 2003/26 për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale:

- a) lëshon licencë për operim me narkotikë, dhe licencë për operim me prekursorë;
- b) lëshon licencë për import dhe eksport të narkotikëve, psikotropëve dhe të prekursorëve si dhe autorizim për kalim tranzit;
- c) lëshon Licencë për Institucioneve të cilat kanë të bëjnë me narkotikë për qëllime mjekësore, shkencore, edukative mjeko-ligjore dhe policore, me pëlqim të Komisionit për narkotik;
- d) përcakton nevojat vjetore për barna narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë;
- e) Dërgon raportet për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët nga Tabelat II, III dhe IV të këtij ligji, në Bordin Ndërkombëtar për Kontroll të Narkotikëve (BNKN) sipas konventave ndërkombëtare për kontroll të narkotikëve.

7.2 Ministria e Shëndetësisë përpilon Planin e veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve të varësisë, si dhe ndërmerr masa për zbatimin e saj, në bashkëpunim me Komisionin për Narkotik.

7.3 Ministria e Punëve të Brendshme dhe Shërbimi Policor i Kosovës përmes njësiteve organizative, kryejn aktivitetet e percaktuara sipas detyrave zyrtare, bëjnë evidentimin e paraqitjeve të veprave penale dhe kundërvajtjeve përkitazi me narkotikët dhe prekursorët, bashkëpunojn me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e keqpërdorimit të narkotikëve dhe prekursorëve të paraqitura në Tabelën I, II, III dhe IV të këtij ligji, i propozojn Qeverisë Planin e Veprimit për luftimin e keqpërdorimit të narkotikëve dhe prekursorëve.

7.4 Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme bën evidentimin e sasisë së konfiskuar të bimëve, narkotikëve, të mirave materiale dhe pronave të tjera nga operimi i ndaluar me narkotikë

7.5 Ministria e Drejtësisë bën evidentimin e personave të dënuar për vepra penale dhe kundërvajtje me narkotikë dhe prekursorë, dhe përcakton sanksionet e masat e tjera ndaj tyre.

7.6 Shërbimi Doganor i Kosovës, bën kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit dhe eksportit, si dhe kalimit tranzit të barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, si dhe mban evidencë për shkeljet doganore.

7.7 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, bën evidentimin e përdoruesve të narkotikëve, që janë shfrytëzues të ndihmave sociale dhe shërbimeve sociale. Harton plane për mbrojtjen e familjeve ose individëve që mund të kenë nevojë për përkrahje sociale, si dhe bashkëpunon me subjektet e tjera në identifikimin, këshillimin dhe referimin e tyre për trajtim të mëtutjeshëm.

7.8 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me AKPM, përcakton kushtet dhe procedurat e operimit me prekursorë të cilët kanë përdorim në industri dhe mbikëqyrë operimin me ta, në bazë të aktit të veçantë nënligjor.

7.9 Ministria e Bujqësisë, bën evidentimin e përdorimit të narkotikëve për qëllime veterinare, si dhe kryen detyra të tjera të cilat i përcakton Komisioni për Narkotik.

7.10 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, harton procedurat për deponimin dhe asgjësimin e bimëve, narkotikëve dhe prekursorëve të konfiskuar.

Neni 8

Raportimi i autoriteteve kompetente

Autoritetet kompetente i raportojnë Komisionit për veprimtaritë e tyre përkitazi me bimët, narkotikët, përgatesat e tyre dhe prekursorët së paku dy herë në vit.

KAPITULLI III KLASIFIKIMI DHE EMËRTIMI I BIMËVE, BARNAVE NARKOTIKE, SUBSTANCIVE PSIKOTROPE, PËRGATESAVE TË TYRE DHE PREKURSORËVE

Neni 9

Tabelat e bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope, përgatesave të tyre dhe prekursorëve si dhe emërtimi i tyre

9.1. Bimët; barnat narkotike, substancat psikotrope, dhe përgatesat e tyre, si dhe prekursorët, në bazë të këtij Ligji, janë të rradhitura në Tabelat I, II, III dhe IV.

Tabela I: Bimët, barnat narkotike dhe substancat psikotrope me rrezikshmëri të lartë që nuk kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë, veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë;

Tabela II: Barnat narkotike dhe substancat psikotrope, me rrezikshmëri të lartë, që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë;

Tabela III: Barnat narkotike, substancat psikotrope dhe përgatesat e tyre, me rrezikshmëri të lartë, që përdoren në mjekësi dhe veterinë;

Tabelën IV: Substancat që përdoren në prodhimin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope – Prekursorët.

9.2 Në Tabelën I janë paraqitur barnat narkotike me emrin e tyre ndërkombëtar, të pambrojtur dhe me emërtim kimik, të klasifikuar sipas Listës I, II, IV të “Konventës

unike ndërkombëtare mbi barnat narkotike” të vitit 1961; dhe substancat psikotrope me emrin e tyre ndërkombëtar të pambrojtur, emërtimin kimik dhe emrat tjerë të pa-mbrojtur apo shkurtesa të klasifikuara në bazë të Listës I, II, III, IV të “Konventës mbi substancat psikotrope” të vitit 1971, përdorimi i të cilave është i ndaluar në Kosovë.

9.3 Në Tabelën II janë paraqitur barnat narkotike dhe substancat psikotrope me emrat e tyre të pambrojtur ndërkombëtar dhe me emërtime kimike të nxjerra nga Listat I dhe II të “Konventës unike ndërkombëtare mbi barnat narkotike” të vitit 1961; si dhe substancat psikotrope me emrat e tyre të pambrojtur ndërkombëtar, dhe me emërtimet kimike si dhe emra të tjerë të pambrojtur apo shkurtesa të klasifikuara në bazë të Listës III dhe IV të “Konventës mbi substanca psikotrope” të vitit 1971; që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinari, dhe janë me rrezikshmëri të lartë.

9.4. Në Tabelën III janë paraqitur substancat psikotrope me emrat e tyre të pambrojtur ndërkombëtar dhe me emërtimet kimike të klasifikuara në bazë të Listës III dhe IV të “Konventës mbi substancat psikotrope” të vitit 1971; dhe përgatesat e barnave narkotike të paraqitura në Listën III të “Konventës së vetme ndërkombëtare mbi barnat narkotike” të vitit 1961; që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinari, dhe janë me rrezikshmëri të lartë.

9.5 Në Tabelën IV janë paraqitur prekursorët në emrin ndërkombëtar, emrin kimik, HS kodi dhe CAS numri, të klasifikuara në 3 kategori në bazë të Regullores (EC) Nr 273/2004 të Këshillit dhe Parlamentit Europian të datës 11.02.2004 mbi prekursorët.

9.6 Tabelat do t’i bashkangjiten këtij ligji në formë të Shtojcës.

9.7 Analogët i nënshtrohen të gjitha dispozitave të përcaktuara me këtë ligj dhe akteve nënligjore në bazë të këtij ligji.

9.8 Barnat narkotike dhe substancat psikotrope nga Tabela II dhe III si shtojcë e këtij Ligji, i nënshtrohen të gjitha dispozitave të parapara në ‘Ligjin për Produkte Medicinale dhe Paisje Medicinale’ nr.2003/26.

Neni 10

Plotësimi dhe ndryshimi i Tabelave

10.1 Përveç përmbajtjes nga paragrafi 1 të nenit 9 të këtij ligji, Tabelat mund të plotësohen edhe me bimë, narkotikë dhe prekursorë të tjerë, si dhe mund të çvendosen bimët dhe narkotikët nga një Tabel në tjetrën, nëse për këtë shfaqet nevoja.

10.2 Plotësimin dhe ndryshimin e Tabelave nga paragrafi 1 i këtij neni, e bënë Qeveria me propozim të Komisionit, duke u bazuar në mekanizmat për ndërrim dhe plotësim të përcaktuara me konventat ndërkombëtare për kontrollin e narkotikëve.

Neni 11

Përgatesat e barnave narkotike dhe substancave psikotrope

11.1 Përgatesat i nënshtrohen dispozitave të njëjta të këtij ligji sikurse edhe substanca të cilën e përmban.

11.2 Nëse përgatesa përmban dy ose më tepër narkotikë, i nënshtrohet dispozitave të cilat aplikohen për substancën e cila paraqet rrezikshmëri më të lartë.

11.3 Përgatesa e cila përmban substanca nga Tabela II, III, IV, e përgatitur ashtu që nuk paraqet rrezik për keqpërdorim ose ai rrezik është i papërfillshëm, e prej së cilës substanca nuk mund të ndahet me metoda të aplikueshme në atë sasi e cila do të mund të keqpërdoret ose të përdoret në mënyrë joligjore, mund të përjashtohet nga masat e caktuara kontrolluese të parapara me këtë ligj.

11.4 Vendimin nga paragrafin 3 i këtij neni e bjen Qeveria në propozim të Komisionit dhe AKPM-së, nën kushtet e paraqitura në paragrafin 2 të nenit 10 të këtij ligji. Me këtë vendim përcaktohen qartë masat e kontrollit nga të cilat përjashtohen këto përgatesa.

KAPITULLI IV RREGULLIMI I VEPRIMTARIVE ME BIMË, BARNA NARKOTIKE, SUBSTANCA PSIKOTROPE DHE PREKURSORË

Neni 12

Prodhimi, qarkullimi me shumicë dhe pakicë i barnave narkotike, substancave psikotrope për qëllime mjekësore

12.1 Prodhimi dhe qarkullimi me shumicë dhe pakicë i narkotikëve nga Tabela II dhe III, u lejohe personave juridik të cilët posedojnë licencë për operim me narkotikë, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet AKPM, dhe që paraprakisht i plotësojnë kriteret për prodhim dhe qarkullim farmaceutik me shumicë dhe pakicë të produkteve medicinale të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale.

12.2 Kushtet e dhënies së licencës dhe procedurat e operimit me barna narkotike dhe substanca psikotrope për qëllime mjekësore përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

12.3 Personat juridik nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar që narkotikët nga Tabela II dhe III, t'i vendosin të veçuara nga produktet e tjera, në hapësira të veçanta ose në arkë metalike ku personat e paautorizuar nuk kanë qasje. Këto hapësira duhet të mbyllën me çelës, të cilin është i obliguar ta mbajë personi përgjegjës.

12.4 Prodhuesit dhe qarkulluesit farmaceutik me shumicë kanë të drejtë të shesin, të blejnë, të bëjnë transaksione apo në ndonjë mënyrë tjetër të vëjnë në qarkullim narkotikët

nga Tabela II dhe III, vetëm përmes personit përgjegjës dhe vetëm nëpërmjet personave juridik të cilët janë të autorizuar për veprimtari me narkotikë.

12.5 Prodhuesit dhe qarkulluesit farmaceutik me shumicë janë të obliguar, që të mbajnë evidencë përkitazi me prodhimin, sasinë dhe llojin e narkotikëve të importuar, të eksportuar, të shitur, të blerë; apo realizimin e transaksioneve, të dokumentuara me fatura hyrëse dhe dalëse; si dhe që t'i dorëzojnë raportet në AKPM, jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo tremujori.

12.6 Qarkulluesit farmaceutik me pakicë kanë të drejtë të blejnë ose të furnizohen me narkotikë nga Tabela II dhe III vetëm nga prodhuesit dhe qarkulluesit farmaceutik me shumicë të cilët posedojnë licencë për operim me narkotikë të lëshuar nga AKPM.

12.7 Qarkulluesit farmaceutik me pakicë kanë të drejtë t'i shesin narkotikë nga tabela II dhe III, vetëm personit fizikë i cili posedon dokumentacionin përkatës mjekësor që parashihet me nenin 14, paragrafi 1 dhe 5.

12.8 Pas ekzekutimit të recetës nga paragrafi 7 i këtij neni, ajo vulozet nga personi përgjegjës i qarkulluesit farmaceutik me pakicë, dhe i vendoset numri rendor i recetave të regjistruara si dhe data e dhënjes së barit.

12.9 Qarkulluesit farmaceutik me pakicë nuk kanë të drejtë t'u shesin barna narkotike dhe substanca psikotrope personave fizik të moshës nën 18 vjet, të cilët janë në trajtim mjekësor. Në këto raste ka të drejtë t'ia shes prindit apo personit tjetër i cili përveq dokumentacionit përkatës mjekësor të paraparë me nenin 14 paragrafi 1, duhet të prezentojë edhe lejen e njoftimit, shënimet e të cilit i evidenton personi përgjegjës i qarkulluesit farmaceutik me pakicë.

12.10 Qarkulluesit farmaceutik me pakicë janë të obliguar të mbajnë evidencë për: recetat e ekzekutuara; sasinë e blerë të dokumentuar me faturë hyrëse; sasinë e shitur dhe sasinë e mbetur, si dhe janë të obliguar që raportet përkitazi me këtë t'i dorëzojnë në AKPM jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo tremujori.

12.11 Prodhuesit dhe qarkulluesit farmaceutik me shumicë dhe pakicë janë të obliguar që gjithë dokumentacionin e përcaktuar me paragrafin 5, 7 dhe 10 të këtij neni ta ruajnë së paku 5 vite.

Neni 13 Operimi me prekursorë

13.1 Operimi me prekursorë nga Tabela IV, u lejohe personave juridikë të cilët pajisen me licencë për operim me prekursorë.

13.2 Kushtet e dhënjes së licencës dhe procedurat e operimit me prekursorë, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

13.3 Personat juridik nga paragrafi 1 i këtij neni kanë të drejtë, që vetëm përmes personit përgjegjës, të shesin, të blejnë, të bëjnë transaksione apo në ndonjë mënyrë tjetër të vejnë në qarkullim prekursorët e kategorisë 1 dhe 2 nga Tabela IV, vetëm nëpërmjet personave juridik të cilët janë të autorizuar për veprimtari me prekursorë.

13.4 Personat juridik nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar t'i vendosin prekursorët nga Tabela IV, të veçuar nga produktet e tjera, në hapësira të veçanta ku personat e paautorizuar nuk kanë qasje. Këto hapësira duhet të mbyllen me çelës, të cilin është i obliguar ta mbajë personi përgjegjës.

13.5 Kompanitë për operim me prekursorë janë të obliguar të mbajnë evidencë përkitazi me importimin, eksportimin, blerjen, shitjen, asgjësimin dhe mbetjen në stok për secilin lloj të prekursorit dhe raportet tremujore t'i dorëzoj në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për prekursorët që kanë përdorim në industri dhe në AKPM për prekursorët të cilët janë barna ose helme, jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo tremujori.

13.6 Evidenca e mbajtur, si dhe faturat hyrëse dhe dalëse ruhen së paku pesë vite.

13.7 Operuesit duhet të sigurojnë që etiketa të jetë e ngjitur në ambalazhën e secilit prekursorë të kategorisë 1 dhe 2, para se të operohet me to. Në etiketë duhet të figuroj emri i prekursorit sikurse janë të paraqitura në tabelën IV.

Neni 14

Blerja, posedimi, konsumimi për trajtim individual

14.1 Për blerje, posedim dhe konsumim të barnave narkotike dhe substancave psikotrope, kërkohet përshkrimi mjekësor në recetë speciale medicinale në pajtim me Ligjin për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale, të lëshuar nga mjeku kompetent.

14.2 Recetat për barna narkotike dhe substanca psikotrope; kategoria e mjekëve të cilët kanë të drejtë t'i përshkruajnë, si dhe mënyra e përshkrimit të tyre, përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

14.3 Nuk konsiderohet import ose eksport, posedimi i barnave narkotike ose substancave psikotrope që bazohet në dokumentacionin mjekësor, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nga ana e personave fizikë që mjekohen nga sëmundja e varësisë ose sëmundjet e tjera të shoqëruara me dhembje të mëdha, ose që janë në fazën terminale të sëmundjeve malinje.

14.4 Sasia e barit narkotik dhe substancës psikotrope të lejuar me paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni duhet të jetë e tillë që mund të shfrytëzohet për trajtim mjekësor brenda 7 ditëve për barnat e Tabelës II dhe brenda 15 ditëve për barnat e Tabelës III.

14.5 Në rastet kur personi fizik që mjekohet nga sëmundjet e numëruara në paragrafin 3 (tre) të këtij neni, nuk është në gjendje shëndetësore për blerjen e barit narkotik apo të substancës psikotrope sikurse është paraparë me paragrafin 1 të këtij neni, atëherë i lejohe personit të tretë ta bëjë këtë ashtu që përveq dokumentacionit mjekësor të paraparë me paragrafin 1 të këtij neni, duhet të prezentojë edhe lejen e njoftimit, shënimet e të cilit i shënon personi përgjegjës i qarkulluesit farmaceutik me pakicë.

14.6 Gjatë kalimit të kufirit personi fizikë nga paragrafi 3 i këtij neni ose përcjellësi i tij është i obliguar ta lajmërojë në doganë emërtimin dhe sasinë e narkotikëve që posedon së bashku me dokumentacionin përkatës mjekësor.

14.7 Është e ndaluar që personi fizikë, të hedhë në ushqim, në lëng apo në mënyrë tjetër ta vë nën eksponim të ndikimit të bimëve dhe narkotikëve personin tjetër fizik.

Neni 15

Veprimtaria në institucionet shëndetësore

15.1 Institucionet shëndetësore, publike dhe private, duhet të pajisen me licencë në Ministrinë e Shëndetësisë nëpërmjet AKPM për veprimtari dhe operim me barna narkotike dhe substanca psikotrope nga Tabela II dhe III, për qëllime mjekësore.

15.2 Kushtet dhe procedurat e licencimit përcaktohen me aktin nënligjor nga neni 12, paragrafi 2 i këtij Ligji.

15.3 Institucionet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni duhet të mbajnë evidencë për: sasinë e blerjes dhe të furnizimit të dokumentuar me faturat hyrëse; llojin e narkotikut, sasinë e përdorur, sasinë e mbetur, sasinë e asgjësuar, dhe të dorëzojnë raportet në AKPM jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo tremujori.

15.4 Evidenca e mbajtur, faturat e blerjes, faturat e shitjes dhe dokumentacioni mjekësor i domosdoshëm për përdorimin e narkotikut nga pacienti, ruhen pesë vite.

Neni 16

Veprimtaria për qëllim të hulumtimeve mjekësore dhe shkencore

16.1 Personave juridik dhe fizikë të cilët mirren me hulumtime mjekësore dhe shkencore u ndalohet blerja, furnizimi, posedimi dhe përdorimi i bimëve dhe narkotikëve nga Tabela I, II dhe III si dhe përgatesave të tyre, nëse nuk posedojnë licencë përkatëse.

16.2 Licencën për veprimtari me narkotikët e Tabelës II dhe III e lëshon Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet AKPM, kurse për bimët dhe narkotikët nga Tabela I Ministria e Punëve të Brendshme, pas pëlqimit paraprak të Komisionit për narkotik.

16.3 Për llojin e bimëve dhe të narkotikëve nga Tabela I, II dhe III, personat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të mbajnë evidencë për: sasinë e blerjes dhe të furnizimit, të dokumentuar me faturë hyrëse, sasinë e përdorur, qëllimin e përdorimit, emrin e personit i cili e ka përdorur, sasinë e mbetur dhe sasinë e asgjësuar, si dhe është i obliguar për raportim vjetor në Komision.

16.4 Evidenca e mbajtur si dhe faturat e blerjes dhe të furnizimit, ruhen pesë vite.

Neni 17

Veprimtaria për qëllime mësimore, edukative dhe policore

17.1 U ndalohet blerja, furnizimi, posedimi dhe përdorimi i bimëve dhe narkotikëve nga Tabela I, II dhe III, si dhe përgatesave të tyre për qëllime mësimore dhe edukim profesional; si dhe për qëllime të dresimit të kafshëve për gjetjen e bimëve dhe narkotikëve; personave fizikë dhe juridikë të cilët nuk posedojnë licencë për këtë veprimtari.

17.2 Licencën për veprimtari me narkotikët nga Tabela II dhe III e lëshon Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet AKPM-së, kurse për bimët dhe narkotikët nga Tabela I e lëshon Ministria e Punëve të Brendshme, pas pëlqimit paraprak të Komisionit për narkotikë.

17.3 Shërbimi policor i Kosovës mund të blej, furnizohet, posedoj, shes, këmbej apo në ndonjë mënyrë tjetër përdorë bimë, barna narkotike, substanca psikotrope nga Tabela I, II dhe III, si dhe përgatesat e tyre, me qëllim të zbulimit të krimit dhe kryesit të veprës. Kjo rregullohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

17.4 Personat juridik dhe fizikë nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të mbajnë evidencë për sasinë e blerjes dhe të furnizimit, sasinë e përdorur, qëllimin e përdorimit dhe personin që e ka përdorur, sasinë e mbetur dhe të asgjësuar si dhe llojin e bimëve dhe narkotikëve nga Tabela I, II, III, dhe përkitazi me këtë të dorëzojnë raporte gjashtëmujore në Komisionin për Narkotik.

17.5 Evidenca e mbajtur si dhe faturat e blerjes dhe të furnizimit, duhet të ruhen së paku pesë vite.

17.6 Kushtet dhe procedurat e lëshimit të licencës për veprimtari, për personat nga neni 16 dhe 17 paragrafi 1 dhe 2 të këtij Ligji, rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, në propozim të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe pas pëlqimit të Komisionit për narkotik.

Neni 18

Veprimtaria për qëllime veterinare

18.1 Ndalohet përdorimi i barnave narkotike dhe substancave psikotrope nga Tabela II dhe III për qëllime veterinarë, përveç prej personave juridik të cilët posedojnë licencë për veprimtari me narkotikë, të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë.

18.2 Veprimtaria me narkotikë dhe përgatesat e tyre për qëllime veterinarë rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë.

KAPITULLI V

DISPOZITAT LIDHUR ME TREGËTINË NDËRKOMBËTARE

Neni 19

Importi dhe eksporti i narkotikëve dhe prekursorëve

19.1 U ndalohet importi dhe eksporti i barnave narkotike dhe substancave psikotrope nga Tabela II dhe III personave fizikë dhe juridikë të cilët nuk posedojnë licencë të patjetërsueshme për import dhe eksport të narkotikëve, psikotropëve të lëshuar Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet AKPM.

19.2 Licenca për import dhe eksport nga paragrafi 1 të këtij neni i lëshohet personave juridik të licencuar për prodhim dhe qarkullim farmaceutik me shumicë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me dispozitat e Ligjit Për Produkte Medicinale dhe Paisje Medicinale nr. 2003/26 për import dhe eksport të produkteve medicinale në Kosovë dhe të cilët posedojnë licencë për operim me narkotikë, psikotrop në pajtim me nenin 12, paragrafin 1 të këtij ligji.

19.3 U ndalohet importi dhe eksporti i prekursorëve të kategorisë 1 dhe 2 nga Tabela IV, personave juridik të cilët nuk posedojnë Licencë të patjetërsueshme për import dhe eksport të prekursorëve, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet AKPM.

19.4 Licenca për import dhe eksport nga paragrafi 3 i këtij neni u lëshohet vetëm personave juridik të cilët posedojnë licencë për operim me prekursorë.

19.5 Në licencën për import dhe eksport të narkotikëve nga tabela II dhe III, figurojnë këto të dhëna:

a) numri i licencës; data e lëshimit; emri dhe adresa e importuesit dhe eksportuesit; emri dhe adresa e prodhuesit; emri tregtar dhe emri gjenerik i barit; sasia e cila do të importohet apo eksportohet; specifikohet koha e validitetit të licencës; si dhe emri dhe mbiemri i autoritetit i cili e lëshon;

b) emri i zyrtarit doganor i cili bën vërtetimin e llojit dhe sasinë e dërgesës, vendin dhe datën e doganimit.

19.6 Në licencën për import dhe eksport të prekursorëve nga tabela IV, figurojnë këto të dhëna:

a) numri i licencës; data e lëshimit; emri dhe adresa e importuesit dhe eksportuesit; emri dhe adresa e prodhuesit; emri i operatorëve të tjerë; emri tregtar dhe emri gjenerik i substancës; sasia e cila do të importohet apo eksportohet; data e arritjes në doganë; pika doganore; shtetet e treta nëpër të cilat do të kalojë tranziti; HS numri; CAS numri; numri i faturës; emri i personit përgjegjës; dhe kompania aplikuese të cilën e përfaqëson (plotësohet nga ana e aplikantit me rastin e tërheqjes së licencës); specifikohet koha e validitetit të licencës dhe emri i autoritetit i cili e lëshon;

b) emri i zyrtarit doganor i cili bën vërtetimin e llojit dhe sasisë së dërgesës; vendin dhe datën e doganimit.

19.7 Afati i validitetit të Licencës për import dhe eksport të narkotikëve, gjegjësisht i Licencës për import dhe eksport të prekursorëve është 3 muaj.

19.8 Kontrolli dhe mbikëqyrja e importit dhe eksportit të barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve do të bëhet nga Shërbimi Doganor i Kosovës.

19.9 Zyra doganore është e obliguar që një kopje të lejes së plotësuar në pajtim me pikën b) të paragrafit 5 dhe 6 të këtij neni t’ia jep personit juridik që operon me këto substanca dhe një kopje brenda 10 ditëve nga dita e doganimit t’ia dërgoj AKPM –së.

19.10 Licenca për eksport lëshohet pas pranimit të licencës për import të lëshuar nga ana e autoritetit kompetent të shtetit importues, të cilën licencë e dorëzon personi juridik i cili aplikon për licencë për eksport.

19.11 Kopja e licencës për eksport duhet ta shoqërojë dërgesën e cila eksportohet dhe një kopje i dërgohet autoritetit kompetent të shtetit importues nga AKPM-ja.

19.12 Pas realizimit të importit apo nëse licencës së importit i skadon validiteti, autoriteti kompetent i shtetit importues duhet ta dërgoj kopjen e licencës së eksportit me të dhënat për rrjedhën e importit dhe sasinë e importuar.

19.13 Nuk konsiderohet import dhe eksport bartja e produktit mjekësor që përmban bar narkotik ose substancë psikotrope i cili është i dedikuar për qëllime të ndihmës së parë mjekësore në aeroplan, të angazhuar në transportin ndërkombëtar në sasinë e nevojshme për këtë qëllim. Përveç dokumentacionit për regjistrimin e mjetit transportues duhet të ekzistojë leja për posedimin e llojit dhe sasisë së caktuar të barit, të lëshuar nga organi kompetent në vendin ku është bërë regjistrimi.

19.14 Produktet medicinale nga paragrafi 13 i këtij neni u nënshtrohen dispozitave ligjore të shtetit ku është bërë regjistrimi i tyre, pa të drejtë të nënshtimit të inspektimit dhe mënyrave të tjera të kontrollit në aeroplan nga ana e autoriteteve kompetente të Kosovës. Administrimi i këtyre produkteve në raste emergjente nuk konsiderohet shkelje e nenit 14 paragrafi 1 të këtij ligji.

Depot doganore dhe zonat e lira doganore

Për substancat nga Tabelat II, III dhe IV të cilat importohen në depo doganore ose në zona të lira doganore, do të zbatohen dispozitat e importit të këtij ligji.

Neni 21 Ndalimi i dërgesave

Shërbimi Doganor ose organet e tjera kompetente, mund ta ndalin dërgesën që përmban substanca nga Tabela II, III, dhe IV, e cila hyn apo del nga territori i vendit tonë dhe e cila nuk është e pajisur me licencë përkatëse për import ose eksport, ose është jashtë kornizës së lejes ekzistuese, derisa nuk vërtetohet se dërgesa e tillë është e lejuar ose derisa nuk vendoset për konfiskimin e dërgesës.

Kalimi Tranzit Neni 22

22.1 Ndalohet kalimi tranzit i narkotikëve të radhitura në Tabelën II, III dhe prekursorëve të kategorisë 1 dhe 2 nga Tabela IV përveç nëse posedojnë:

- a) autorizimin e eksportit të shtetit që i eksporton;
- b) autorizimin e importit të shtetit që i importon;
- c) autorizimin e tranzitit të lëshuar nga AKPM-ja dhe autorizimet e vendeve të tjera deri në destinacionin e fundit, respektivisht vërtetimi i organit kompetent të atij vendi se tranziti i substancave të tilla nuk është i kushtëzuar me leje te veçantë.

22.2 Kontrolli dhe mbikëqyrja e kalimit tranzit të barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve do të bëhet nga Shërbimi Doganor i Kosovës.

22.3 Zyra doganore është e obliguar që:

- a) atë vërtetoj llojin dhe sasinë e substancave për secilën dërgesë;
- b) të shënoj në deklaratën doganore se cili është vendi dërgues dhe cili është vendi pranues;
- c) të lajmëroj menjëherë Ministrinë e punëve të brendshme.

22.4 Shërbimi Doganor në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme ndërmerr të gjitha masat që të pengoj ndërrimin e destinacionit të dërgesës nga ajo që është e paraqitur në autorizimin e eksportit përveç nëse AKPM-ja jep pëlqimin për këtë ndërrim. Në këtë rast dërgesa do të trajtohet si eksport nga vendi ynë në destinacion të ri kurse AKPM-ja i dërgon të dhënat autoritetit kompetent të shtetit prej ku është lëshuar autorizimi origjinal i eksportit sikurse është e paraparë me nenin 19 paragrafi 12.

22.5 Dërgesa gjatë tranzitit ose deri sa të deponohet në destinacionin e paraparë, nuk lejohet t'i nënshtrohet proceseve të cilat ndryshojnë natyrën e substancave në fjalë. Paketimi nuk lejohet të ndërrohet pa pëlqimin e AKPM-së.

Neni 23
Tranziti ajror

Neni 22 i këtij ligji nuk aplikohet kur ngarkesa deri në shtetin tjetër transportohet me rrugë ajrore vetëm nëse nuk ateron në Kosovë, në të kundërtën i nënshtrohet të gjitha dispozitave të parapara me këtë ligj.

Neni 24

Kushdo që në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji importon, eksporton apo kalon si tranzitë substancat nga Tabela II, III apo IV, do t'i nënshtrohet dispozitave ndëshkimore të parapara me dispozitat e këtij ligji.

Neni 25
Transportimi

